

## NE RP TE KINES



Skenë nga opera e Pekinit «Beteja në fushë».

## Zhvillim i koreografisë së re socialiste

**Q**ë nga koha e Revolucionit të Madhi Kultural Proletar arti koreografik në Kinë ka arritur suksese të reja në krijimin, e figurave të heronjeve proletarë, në pasqyrimin e frymës së epokës socialistë.

Janë vënë një sërë veprash të baletave revolucionare të tillë si «Detashmenti i kuq i grave», ku pasqyrohet procesi i krijimit, rritjes dhe forcimit të detashmentit revolucionar të grave nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës, baleti «Vajza me flokë të thnjura», ku me fatin e familjes së Si-Erit, vajzës së një fshatarit të varfér, tregon se si fshatarët e varfér të Kinës i nënshtrohen në shatypjes së egër të klasës së cifligarëve dhe se si ata u futën në rrugën revolucionare; baleti «Femijet e Stepës», ku del se fëmijët kinezë kaliten dhe forcohen në luftën klasore dhe prodhuese.

Koreografia në Kinë është socialiste, si dhe llojet e tjera të letërsisë dhe artit i shërbijnë politikës proletare, i shërbijnë punëtorëve, fshatarëve, ushtarëve, dhe ndërmimit socialist.

Mbas krijimit të RP të Kinës, në fushën e letërsisë dhe të artit u bë një lufte e ashper midis vijës revolucionare të Kryetarit Mao Ce Dun dhe vijës revisioniste Liu Shao Cisë. Aspekti i rëndësishëm i kësaj lufte ishte qëndrimi kritik ndaj trashëgimisë së letërsisë dhe artit kinez dhe vendeve të tjera.

Të udhëhequr nga vija revolucionare e Kryetarit Mao Ce Dun në fushën e letërsisë dhe artit, proletariati filloi revolucionin në fushën e letërsisë dhe artit që

nga transformimi i operës së vjetër të Pekinit dhe krijimi i saj mbi bazë të reja.

Në baletin e njohur revolucionar «Detashmenti i kuq i grave» janë krijuar me sukses figurat e shkëlqyera të heronjeve proletarë - komunisti Hu Cin Cin, që lufton heroikisht për cilimin e popullit dhe revolucionarja e pamposhtur U Cin Hua. Ky balet mban qëndrim kritik ndaj çdo gjëje që ruan forcën jetësore në artin koreografik tradicional të huaj dhe kinez dhe krijoj një sistem krejt të ri të mjeteve koreografike. Për të pasqyruar temën e madhe të luftës popullore dhe për të krijuar figurat e shkëlqyera të heronjeve proletarë autorët e baletit hodhën poshtë shablonet e baletit të vjetër. Në duatin e U Cin Hua dhe kundërrevolucionarit Liao Së jepet luftimi trup me trup. Përlleshjet e heroit kryesor, Hun Can Cin me përkrahësit e cifligarit tregojnë guximin dhe shkathtësinë e heroit dhe ngathtësinë e armiqve.

Revolucionari, në fushën e artit të baletit, krijoj shpejt mjaft koreografë që i shërbijnë me të gjitha forcat punëtorëve, fshatarëve dhe ushtarëve. Tani, pothuajse në të gjitha provinçat, qytetet dhe rajonet autonome si dhe në shumë qarqe dhe distrikte të vendit janë krijuar kolektiva artistike. Në një sërë rajone shë vendit janë krijuar shkolla dhe kurse koreografike. Përveç kësaj grupet artistike amatore janë zhvilluar gjerësisht në uzina, fshatra, reparte ushtarake, institucione dhe shkolla.

(ATSH)

## Dak humor

Nga Zef Bumci



Bota - Mës u habit hënë, unë nuk çuditem.

Shtetet e Bashkuara i shitën Bashkimit Sovjetik 2 milion ton grurë me kërkesën e ketij të fundit.



Daj Sami «bujar» dhe lypesi klasik.

KOLEGJUMI I REDAKSISE